



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. **78** /2022
Datë: 18.07.2022

Bazuar të nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 të datës 01 mars 2019), duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren (QRK) Nr. 16/2022 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe opinionin ligjor të DMZP/MPB të datës 29.06.2022, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

mbi anulimin e Konkursit për lëvizje brenda kategorisë

1. Anulohet procedura e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën: Udheheqës i Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike /Departamaneti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme i publikuar sipas datës së Njoftimit me 07.03.2022 dhe afatit për aplikim nga data 22.03.2022 deri 30.03.2022.
2. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerezore për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Divizioni i Burimeve Njerezore bazuar në Vendimin mbi miratimin e fillimit të procedurës së rekrutimit për Pozitën: Udheheqës i Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike /Departamaneti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me nr. 29/2022 të datës 28.02.2022, ka filluar zhvillimin e kesaj procedure të rekrutimit duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për Zyrtarët Publik. Pas përfundimit të fazës së verifikimit paraprak dhe afatit të ankesave, Divizioni i Burimeve Njerezore në kaudër të Ministrisë së Drejtësisë ka përgaditur dhe dërguar për aprovim propozimin për themelimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë (KVLBK).

Duke u bazuar në paragrafin 4 të nenit 34 të Ligjit NR. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik, paragrafin 3 të nenit 9 dhe paragrafin 4 të nenit 15 të Rregullores Nr. 16/2020 për pranim dhe karrierën në Shërbimin Civil, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 98 dhe paragrafin 1 të Nenit 130 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative 05/L-031 dhe opinionin ligjor të DMZP/MPB të datës 29.06.2022 i cili përcakton se:

“afati për përfundimin e një procedure të rekrutimit është dyzetepesë (45) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve”, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- *Divizioni i Burimeve Njerëzore /MD;*
- *Arkivit të MD-së;*